

PROMALT normal / i shpejtë

Llaç i përforcuar me fibër

Karakteristika

PROMALT (me ngrirje normale) dhe **PROMALT** i shpejtë (me ngrirje të shpejtë) janë solucione të parapërziera antitkurrje, tiksotropike (gjatë përzierjes mund të lëngëzohet dhe e kundërta) dhe e përforcuar me fibër, të përbëra nga lidhje çimentuese shtresa kimike dhe inerte të thërrmuara të përzgjedhura, të cilat i japin karakteristika qëndrueshmërie mekanike të lartë bashkë me mundësinë për të kryer mbushje vetëmbështetëse me trashësi të madhe, pa qenë nevoja për punime në strukturën në prishje.

Fusha e përdorimit

Restaurim strukturash betoni çimento armato, si korniza, ballkone, shtylla, dysheme, shkalla, ballore si dhe për riparim kavitetesh të formuara gjatë lëvizjes së vatrave të zhavorrit apo hekurave distancues. Për mirëmbajtje zakonisht ku nevojitet një ripërdorim i shpejtë produktit.

Avantazhe

- Mundësi për mbushje të trashë me një përdorim
- Ekonomi operative
- Nuk ka nevojë për pjekje të gjatë me ujë
- Ngjitje mbi çdo lloj suporti pa qenë nevoja e përdorimit të primerit.

Materialet e duhura

- Beton, suva dhe gurishte të çimentuara

Përgatitje e sipërfaqeve

Sipërfaqet duhen të jenë kompakte, pa gjurmë skelash, të pastra dhe pa praninë e pjesëve inkoherente apo në fazë shkëputjeje. Të eliminohet çdo gjurmë ndryshku nga hekurat e armaturës së ekspozuar dhe pasivizim i tyre me anë të përzierje të hollë çimento FERMALT (vërej skedën teknike).

Kryej restaurimin me PROMALT brenda 2 orësh qysh nga trajtimi pasivizues, lagje paraprake me kujdes e mbajtëses, duke pasur parasysh ngjitjen mirë të produktit mbi gjithë sipërfaqen që duhet restauruar.

Mënyra përdorimi

Përziej një thes 25 kg PROMALT me rreth 3.5-4 litra ujë të pastër ose PROMALT të shpejtë me rreth 4-4.5 litra ujë të pastër duke përdorur një trapon përzierës me numër të vogël rrotullimesh. Përdore PROMALT mbi sipërfaqen që është për t'u restauruar, me trashësi 1-4 cm për çdo aplikim, sipas nevojës. Shtresa të mëtejshme të produktit vihen më pas kur aplikimi i mëparshëm ka filluar të kapë. Duke qenë përsëri në fazën e kapjes, jepi dorën e fundit sipërfaqes me perdash sfungjeri ose plastik.

Vërejt! Kur ka temperatura të larta, këshillohet të mbahet e thatë sipërfaqja e restauruar për të paktën 24 orë.

Finitura: **PROMALT – PROMALT** i shpejtë mund të lëshohet me sy ose i rrafshuar me EKOPLAST të rrafshët ose PROTIXO dhe i zbukuruar me bojëra sintetike ose me mbrojtës antikarbonizues.

Të dhëna teknike dhe aplikuese

	<i>Normal</i>	<i>I shpejtë</i>
* Pamja	pluhur ngjyrë gri çimento	pluhur ngjyrë gri çimento
* Peshë specifika e përbërjes së freskët	rreth 2.100 kg/m ²	rreth 2.200 kg/m ³
* Paketim	thes 25 kg	
* Konsumi i mesëm për cm trashësi	rreth 18 kg pluhur/m ²	rreth 19 kg pluhur/m ²
* Ujë për përzierje	17-18%	15-17%
* Qëndrueshmëria në përkulje (pas 28d.)	7,5 Mpa	50 Mpa
* Qëndrueshmëria në ngjeshje (pas 28d.)	45 Mpa	50 Mpa
* Ngjijtje me beton (pas 28d.)	1,5 N/mm ²	
* Koha e përzierjes (20°C)	rreth 40 minuta	rreth 10 minuta
* Diametri maksimal inert	3 mm	
* Trashësia minimale e mbushur	1 cm	
* Trashësia maksimale për dorë	5 cm	4 cm
* Koha e aplikimit	+5 / +35°C	
* Koha e ruajtjes	12 muaj po u mbajt në mjedis të thatë e të freskët në pako origjinale të vulosura	

Paralajmërime

- ** Mos i shto ujë përzierjes në fazë kapjeje
- ** Kur ka temperatura të larta, të laget vazhdimisht sipërfaqja e restaruar për të paktën 24 orë
- ** Të mos përdoret mbi sipërfaqe të tejnxehura, kur ka erë të fortë apo në pishë të diellit
- ** Të mos përdoret mbi sipërfaqe të ngrira, në fazë shkrirjeje apo që mund të shkrihet në 24 orët e ardhshme
- ** Të mos përdoret mbi sipërfaqe të paqëndrueshme apo në fazë shpëputjeje apo me prani allçie
- ** Të mos aplikohet me trashësi më të vogël se 1 cm

Qëndrueshmëri mekanike: qëndrueshmëritë teknike, të pasqyruara në tabelë, janë nxjerrë nga mostra 4 x 4 x 16 cm, të përgatitura në laborator me 17,5% ujë e të pjekura në 20°C e U.R. 90%. Ndërkaq të dhënat mund të ndryshojnë nëse ndryshojnë kushtet e përzierjes e të të pjekurit.

Vërejt! Të dhënat e mësipërme u referohen provave laboratorike në mjedis të kushtëzuar e mund të jenë të modifikuara ndjeshëm nga kushtet e zbatimit.